



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 11 nëntor 2024
Nr. ref.: RK 2574/24

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI109/23

Parashtrues

Basri Blakqori

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AC-I-15-0157-A0001 të 3 shkurtit
2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Bajram Ljatifi, gjyqtar
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar
Enver Peci, gjyqtar dhe
Jeton Bytyqi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

- Kërkesa është parashtruar nga Basri Blakqori, me vendbanim në Komunën e Prishtinës, i cili përfaqësohet nga Kadri Begolli, avokat në Komunën e Prishtinës (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin [AC-I-15-0157-A0001] e 3 shkurtit 2023 të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit i DHPGJS-së), në ndërlidhje me Aktgjykimin [C-I-14-0016] e 22 korrikut 2015 të Kolegjit të Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtëpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 46 [Mbrotjtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës [në tekstin e mëtejme: Kushtetuta], në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) dhe nenin 1 të Protokollit nr 1 (Mbrotjtja e pronës) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ-ja).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 (Procedimi i kërkesës) dhe 47 (Kërkesa individuale) të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 25 (Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve) të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).
5. Më 7 korrik 2023, Rregullorja e punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës Nr. 01/2023, u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe hyri në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht gjatë shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese i referohet dispozitave të Rregullores së lartcekur. Lidhur me këtë, konform Rregullit 78 (Dispozitat kalimtare) të Rregullores së punës Nr. 01/2023, përjashtimisht, dispozita të caktuara të Rregullores së punës Nr. 01/2018, do të vazhdojnë të zbatohen në lëndët e regjistruara në Gjykatë përpara shfuqizimit të saj, vetëm nëse dhe për aq sa janë më të favorshme për palët.

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 30 maj 2023, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme Gjykata).
7. Më 31 maj 2023, Kryetarja e Gjykatës përmes Vendimit [GJR.KI109/23] caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka Nimani (kryesuese), Radomir Laban dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 6 qershor 2023, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës. Në të njëjtën ditë, një kopje e kërkesës iu dërgua Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.
9. Më 21 nëntor 2023, Gjykata kërkoi nga DHPGJS-ja dosjen e plotë të lëndës.

10. Më 23 nëntor 2023, Gjykata pranoi nga DHPGJS-ja dosjen e plotë të lëndës në mënyrë elektronike.
11. Më 11 mars 2024, gjyqtari Jeton Bytyqi dha betimin para Presidentes së Republikës së Kosovës, me ç' rast filloi mandati i tij në Gjykatë.
12. Më 29 prill 2024, Kryetarja e Gjykatës njoftoi zëvendëskryetarin e Gjykatës dhe kërkoi përjashtimin nga procesi i shqyrtimit dhe vendimmarrjes lidhur me këtë rast.
13. Më 2 maj 2024, Gjykata aprovoi kërkesën për përjashtim të Kryetares Gresa Caka-Nimani, në cilësinë e gjyqtares nga procesi i shqyrtimit dhe vendimmarrjes lidhur me këtë rast.
14. Më 7 maj 2024, Gjykata përmes Vendimit [Nr.KSH.KI109/23] caktoi gjyqtarin Bajram Ljatifi anëtar në Kolegjin Shqyrtues në vend të Kryetares, përkatësisht gjyqtares Gresa Caka-Nimani.
15. Më 17 korrik 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtares raportuese dhe vendosi që rasti të shtyhet për shqyrtim në një nga seancat e radhës, me kërkesë që i njëjti të plotësohet me sqarime shtesë.
16. Më 1 tetor 2024, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtares raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: AKP), në një datë të paspecifikuar shpalli njoftimin për shitjen përmes likuidimit për njësinë numër 71, "Gërmia Shitorja nr. 197 Prishtinë/Shitja e Aseteve 23".
18. Më 13 dhjetor 2013, AKP-ja njoftoi parashtruesin e kërkesës se ishte shpallur ofertuesi me çmimin më të lartë të ofruar, dhe se Bordi i AKP-se do të merrte vendim mbi ofertuesin fitues apo anulimin e shitjes.
19. Më 4 shkurt 2014, AKP-ja njoftoi parashtruesin e kërkesës se bordi i saj në mbledhjen e mbajtur më 31 janar 2014, kishte vendosur për anulimin e tenderit për njësinë numër 71, "Gërmia Shitorja nr. 197 Prishtinë/Shitja e Aseteve 23", dhe se kishte mundësi që brenda afatit 120 ditor të iniciohte padi pranë DHPGJS-së.
20. Më 4 mars 2014, parashtruesi i kërkesës e njoftoi AKP-në se do të parashtronte padi në DHPGJS, kundër vendimit të Bordit të AKP-së për anulimin e tenderit.
21. Më 6 maj 2014, parashtruesi i kërkesës parashtroi padi në DHPGJS kundër AKP-së, me pretendimin se vendimi i Bordit të AKP-së nuk përmban arsyetim por vetëm citim të dispozitave ligjore, dhe se ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe rregullat e përgjithshme të tenderit. Parashtruesi i kërkesës kërkoi anulimin e vendimit të Bordit të AKP-së dhe vërtetimin si fitues i tenderit.
22. Më 14 maj 2015, AKP-ja dorëzoi përgjigjen e saj në padi në DHPGJS kundër pretendimeve të parashtruesit të kërkesës. AKP-ja argumentoi se bordi i saj kishte vepruar në përputhje me Ligjin nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe me rregullat e aplikueshme të tenderit. Sipas AKP-së, çmimi i ofruar nga parashtruesi i kërkesës nuk ishte në përputhje me vlerën e asetit të tenderuar, dhe në rastet e tilla, është në diskrecionin e bordit të pranojë apo anulojë shitjen e asetit.

23. Më 15 maj 2015, parashtruesi i kërkesës propozoi edhe caktimin e masës së sigurimit, në mënyrë që t'i ndalohej AKP-së shitja e asetit të tenderuar, deri në vendimin gjyqësor.
24. Më 9 korrik 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [C-I-14-0016] refuzoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës për masë të përkohshme dhe arsyetoi si në vijim:

“Neni 17.2 i Rregullave të tenderit parasheh se ofera mund të anulohet nëse është e pamjaftueshme ekonomikisht. Kjo referencë ndaj nenit 17.2 (c) e Rregulltave të tenderit ofron arsyetim të mjaftueshëm për paditësin. Dhe parashtresa e të paditurit në mbrojtje kundër kërkesës për masë të përkohshme e përsërit këtë. Sipas kësaj e paditura e ka vlerësuar vlerësn e pjesës së tokës se qartazi tejkalon shumë prej 452.000 euro. Duke u bazuar në këtë është e mjaftueshme se bordi i të paditurës konsideron të domosdoshme që të anulohet tenderi me ofertën më të lartë prej 280.001 euro si të pamjaftueshme ekonomikisht. Si rrjedhojë është e dukshme se padia nuk do të jetë e suksesshme”.

25. Më 22 korrik 2015, Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së përmes Aktgjykimit [C-I-14-0016] refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar. DHPGJS-ja arsyetoi si në vijim:

“Neni 17.2 i Rregullave të tenderit parasheh se oferta mund të anulohet nëse është e pamjaftueshme ekonomikisht. Kjo referencë ndaj nenit 17.2 (c) e Rregulltave të tenderit ofron arsyetim të mjaftueshëm për paditësin. Dhe parashtresa e të paditurit në mbrojtje kundër kërkesës për masë të përkohshme e përsërit këtë. Sipas kësaj e paditura e ka vlerësuar vlerësn e pjesës së tokës se qartazi tejkalon shumë prej 452.000 euro. Duke u bazuar në këtë është e mjaftueshme se bordi i të paditurës konsideron të domosdoshme që të anulohet tenderi me ofertën më të lartë prej 280.001 euro si të pamjaftueshme ekonomikisht”.
[...]

“Si rrjedhojë, anulimi i ofertës fituese të paditësit ka qenë i ligjshëm. Këtu duhet të vihen në pah dy aspekte: Së pari, në procedurën e tenderit paraprak ka qenë oferta prej 452.000 euro për të njëjtat arsye. Kjo paraqet se tregu e ka potencialin për të ngritur shumë më tepër çmimin sesa oferta e paraqitur nga ana e paditësit. Së dyti, fakti se i paditri e ka anuluar ofertën prej 452.000 euro tregon se i padituri në fakt beson se vlera e aseteve është shumë më e lartë se kaq. Prandaj, është e besueshme se i padituri nuk e ka anuluar tenderin në mënyrë arbitrare për paditësin. Përkundrazi, i padituri bazuar në zbatimin e mirëfilltë të lirisë së veprimit të tij përmes aplikimit të kriterëve objektive ka ardhur në përfundimin se oferta ka qenë e pamjaftueshme. Prandaj, nuk ka asnjë bazë që të shfuqizohet anulimi i ofertës fituese. Me anulimin e ofertës fituese, paditës nuk ka të drejtë të lidhë kontratë të shitjes në bazë të asaj oferte”.

26. Më 29 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit të DHPGJS-së, kundër Aktvendimit [C-I-14-0016] i Kolegjit të Specializuar DHPGJS-së për refuzim të masës së përkohshme. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se kishte ofruar argumente të besueshme për bazën e kërkesës, se pa caktimin e masës së përkohshme do të vështirësohej realizimi i kërkesës dhe do të shkaktohej dëm i pariparueshëm.

27. Më 18 gusht 2015, parashtruesi i kërkesës parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit kundër Aktgjykimit [C-I-14-0016] të DHPGJS-së, për shkak të konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të ligjit. Parashtruesi i kërkesës pretendonte që: (i) Aktgjykimi i DHPGJS-së ishte marrë pa seancë gjyqësore; (ii) gjendja faktike ishte vërtetuar në mënyrë të gabuar; (iii) aktgjykimi ishte i paqartë dhe që çmimin e përcakton tregu i lirë.
28. Më 6 prill 2016, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-15-0157] e konsideroi të tërhequr ankesën e parashtruesit të kërkesës në lidhje me masën e përkohshme, me arsyetimin se ky i fundit nuk e kishte paguar taksën gjyqësore, siç ishte kërkuar nga ai përmes vërejtjes dhe as nuk kishte bërë kërkesë për lirim nga pagesa.
29. Më 22 prill 2016, parashtruesi i kërkesës parashtroi propozim për kthimin e procedurës në lidhje me masën e përkohshme në gjendje të mëparshme, me arsyetimin se e kishte paguar taksën gjyqësore pas pranimit të vërejtjes, dhe kopjen e fletpagesës e kishte dorëzuar në zyrën e DHPGJS-së.
30. Më 14 shtator 2017, Kolegji i Apelit nëpërmjet Aktvendimit [AC-I-16-0080] miratoi si të bazuar propozimin e parashtruesit të kërkesës për kthimin e procedurës në lidhje me masën e përkohshme në gjendjen e mëparshme dhe vendosi që ankesa fillestare do të gjykohej nën numrin e mëparshëm të lëndës. Kolegji i Apelit arsyetoi se në fillim nuk kishte dëshmi që parashtruesi i kërkesës e kishte paguar taksën gjyqësore dhe procedura ishte ndërprerë për shkak të gabimit të zyrës së regjistrimit të gjykatës.
31. Më 26 shtator 2019, Kolegji i Apelit i DHPGJS-së përmes Aktvendimit [AC-I-15-0157], refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës në lidhje me propozimin për caktimin e masës së përkohshme, me arsyetimin se parashtruesi i kërkesës nuk kishte argumentuar që mund t'i shkaktohej ndonjë dëm i pariparueshëm.
32. Më 3 shkurt 2023, Kolegji i Apelit përmes Aktgjykimit [AC-I-15-0157-A0001] refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës kundër Aktgjykimit [C-I-14-0016] të DHPGJS-së si të pabazuar. Kolegji i Apelit arsyetoi si në vijim:

“Në rastin konkret Bordi i AKP-së kishte vendosur që të mos aprovoj shitjen për shkak të çmimit të lirë të ofruar, që sipas vlerësimit të shkallës së parë të DHPGJS dhe Kolegjit të Apelit është në pajtim me ushtrimin e arsyeshëm të autoritetit të saj”.
[...]

“Për më tepër Kolegji i Apelit thekson se gjykata nuk është e autorizuar me ndonjë dispozitë ligjore ta obligoj AKP-në që të nënshkruaj kontratën sepse AKP-ja është organ i pavarur publik (neni 1.1 i Ligjit për AKP-në) dhe prandaj është e pavarur të vendosë me kë të futet në marrëdhënie kontraktuale”.

“Nga këto arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ankesa e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

33. Parashtruesi i kërkesës pretendon që Aktgjykimi [AC-I-15-0157-A0001] i Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së i datës 3 shkurt 2023, ka shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt gjyqësor) të

KEDNJ-së, dhe nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit nr 1 (Mbrojtja e pronës) të KEDNJ-së.

A. Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

(i) përkitazi me tejzgjatjen e procedurës gjyqësore

34. Parashtruesi i kërkesës fillimisht i referohet dhe citon praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ-së) e cila përcakton parimet për vlerësimin e tejzgjatjes së procedurës dhe më pas specifikisht pretendon se: *“Sa i përket fakteve të rastit AKP dhe Gjykata nuk kanë patur nevojë për interpretime të ndonjë marrëveshje ndërkombëtare por vetëm interpretimin e dispozitave vendore pozitive, pastaj nuk kanë patur ligj të ri për aplikimin ose që i njëjti të mos jetë i qartë, nuk ka patur çështje diskutabile të juridiksionit, zbrazëtirave ligjore mes ligjit procedural dhe atij material. Në aspektin e kompleksitetit procedural AKP dhe Gjykata në procedurë nuk kanë patur numër të madh të palëve ose dëshmitarëve, nuk ka pasur kërkesa të mëdha të kërkuarve homolog të parashtruar nga palët, ose sigurimin e materialeve nga organet tjera administrative apo nga gjykatat tjera. Si rezultat i stërgjatjes së proceseve parashtruesi i kësaj kërkesë konsiderohet viktimë sipas nenit 6.1 të Konventës”.*
35. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se: *“Rasti në fazën fillestare tek AKP dhe më vonë në gjykatë nuk ka qenë rast i komplikuar, ankuesi gjatë gjitha fazave të procedimit të rastit ka qenë palë e disiplinuar, korrekte, bashkëpunuese dhe me asnjë veprim nuk ka ndikuar në stërgjatjen e proceseve, veprimet e organeve të sistemit të përfshirë në vendosjen e të drejtës civile të caktuar ishin neglizhente, të vonuara, stërgjatje pa arsye gjë që ka ndikuar në të drejtat e këtij ankuesit”.*

(ii) përkitazi me shkeljen e “barazisë së armëve” dhe mos mbajtjen e seancës dëgjimore

36. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Barazia në mjete dhe e drejta për t’u vënë në dijeni për faktet e argumentet e palës kundërshtare dhe asnasjelltas e drejta për një seancë të drejtë përfshin parimin e barazisë së mjete. Kjo nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabartë që të paraqesë çështjen e vet dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë ndonjë avantazh të konsiderueshëm ndaj kundërshtarit”.*
37. Parashtruesi i referohet dhe citon praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe thekson se: *“E drejta për një seancë të drejtë përfshin gjithashtu nocionin që të dy palët në proces kanë të drejtë të kenë informacion për faktet dhe argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë për pasje të seancës civile apo penale që të kenë qasje në provat dhe komentet e marra”.*
38. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Aktgjykimi i kontestuar përfundimtar është marrë pa ndonjë seancë gjyqësore gjë që bie ndesh me dispozitën e nenit 182 lidhur me nenin 4, 5, dhe 7 të LPK-së. Duke vepruar në këtë mënyrë Gjykata që nga fillimi i procesit ua ka mohuar palëve të drejtën e shqyrtimit të çështjes kontestuese në seancë të drejtëpërdrejtë (parashtruesi-paditësi asnjëherë që nga fillimi i procesit për mbrojtje gjyqësore nuk është ftuar nga gjykata për deklarin lidhur me pretendimet e paraqitura dhe publike) me cëka është shkelur parimi i publicitetit të garantuara me nenin 4.1 të LPK dhe parimi i disponibilitetit të palëve i garantuar me 5.11 dhe 7 të LPK”.*

(iii) përkitazi me mungesën e arsytimit të vendimeve gjyqësore

39. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Përkundër çmimit më të lartë të ofruar nga pala ankuese, megjithatë, ishte anuluar tenderi se gjoja ky nuk është çmimi real. Në këtë rast, Bordi i Drejtorëve në mënyrë arbitrare kishte vendosur anulimin pa dhënë ndonjë arsytim dhe pa nxjerr ndonjë ekspertizë për këtë. AKP-ja ka abuzuar me autorizimet e saja ligjore për faktin se njoftimin për anulimin e tenderit nuk e ka bazuar në ndonjë provë të vlefshme materiale ose formale të përcaktuar me Rregullat e përgjithshme të Tenderit, sic ka mundur të ishte psh. Kryerja e ndonjë ekspertize përkatëse me të cilën do të mund të arsyetonte ekonomikisht pamjaftueshmërinë e çmimit më të lartë të ofruar nga ankuesi por vendimmarrjen e saj, jo ligjore, e ka mbështetur në pretendimet e supozuara se kapaciteti ekonomik i tregut për pronën e tenderuar, është më e lartë se shuma e ofruar për të cilën shumë herë AKP-ja e ka konstatuar si shumë më e lartë e ofruar”.*
40. Tutje, parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Gjykata lidhur me pretendimet e ngritura me padinë e prashtruar, me datë 06.05.2014, dhe vendimmarrjen me aktgjykimin e kontestuar nuk ka respektuar standardin e arsyetuar të vendimeve gjyqësore, dhe si i tillë, bie ndesh me garancintë e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së. Aktgjykimin përfundimtar i mungon arsytimi mbi faktet vendimtare. Kështu në këtë aktgjykim nuk shpjegohet se në çfarë procedure janë konstatuar faktet në të cilat mbështetet aktgjykimi.”*
41. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se: *“Pala ankuese konsideron se në Gjykata kishte paraqitur kërkesë të qartë për anulimin e vendimit përkatës të AKP duke këmbëngulur në qëndrimet e veta të shprehura edhe në gjykatat e instancave më të ulëta dhe, në mes tjerash, në kërkesë ka theksuar qartë se vendimi i AKP, i kontestuar për anulimin e tenderit, ishte marrë me shkelje ligjore të Rregullave Të Përgjithshme Të Tenderit. Pala ankuese qarta ka theksuar se kjo çështje e ngritur në gjykatë të shkallës së parë dhe të dytë jo vetëm se nuk është korriguar nga Gjykata e shkallës së dytë, por nuk është adresuar fare. Mbi këtë bazë, pala ankuese konsideron se Dhoma e Posaçme nuk i ka adresuar në mënyrë të plotë pretendimet ankimore, për shkeljet procedurale dhe materiale të bëra nga Gjykata dhe se mungesa e adresimit të plotë të pretendimeve, dhe dhënia e përgjigjes adekuate në pretendimet e ankuesit, përbëjnë një të metë të pakapërcyeshme të përmbajtjes së aktgjykimit dhe arsytimit të gjykatës me cka Gjykata nuk ka respektuar standardin kushtetues të arsytimit të vendimit gjyqësor”.*

B. Pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së

42. Parashtruesi fillimisht thirret dhe citon përmbajtjen dhe garancitë e të drejtës në pronë si dhe përmend disa raste nga praktika gjyqësore e GJEDNJ-së bazuar në nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së dhe më pas specifikisht pretendon se: *“Çështja e dëmit material të cilin e ka pësuar pala duke iu nënshtruar tenderave në vazhdimësi, para Gjykatës Kushtetuese paraqitet si dëmtim i të drejtave pasurore të palës. Të drejtat pasurore në Kushtetutë janë të mbrojtura me nenin 46. Sipas kuptimit të këtij neni termi “pronë” është e përfshirë çfarëdo pasurie apo interes që në një mënyrë ose tjetër dëmton interesat pasurore të palës.”*
43. Parashtruesi i kërkesës pretendon se: *“Pasojat e anulimit në mënyrë të padrejtë të tenderit dy herë me radhë nga AKP, i shkaktojnë palës ankuese dëm material të konsiderueshëm, dhe me këtë cenim të drejtës pasurore/pronësore. Anulimi i njëpasnjëshëm i tenderit coi në një humbje materiale të palës ankuese në shumë prej afër 300.000.00 euro. Sepse pala ankuese sa her që anulohet pa arsye dhe shpallej*

tenderi ishte e detyruar të rriste shumën/çmimin për asetin. Ku në rastin tonë, sa herë që pala ankuese shpallej fitues-krijohej një pritje legjitime se ai tani është blerës dhe i takon e drejta mbi pronën. Ndërsa, pas një kohe i mohohej kjo e drejtë”.

44. Parshtuesi i kërkesës duke u thirrur dhe cituar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së thekson: “Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut ka njohur si civile një numër të drejtash të tilla dhe detyrimesh. Prona është një fushë ku Gjykata është shprehur se është i zbatueshëm neni 6. Në fazat e mëposhtme garantoht zbatimi i procesit të drejtë gjyqësorë si shpronësimi, konsolidimi dhe procedimet e planifikimit dhe proceduarit në lidhje me ndërtimet e Lejet e tjera për pasuri të patundshme, të cilat kanë pasoja të drejtpërdrejta mbi të drejtën e pronësisë në lidhje me përfshirjen e pronës përkatëse dhe gjithashtu procedurë më të përgjithshme ku rezultati ka impakt mbi gëzimin e pronës”.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 31

[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.
 2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.
- [...]

Neni 46

[Mbrojtja e Pronës]

1. E drejta e pronës është e garantuar.
- [...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6

(E drejta për një proces të rregullt gjyqësor)

1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij [...]

Protokolli numër 1 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 1

(Mbrojtja e pronës)

Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën e gëzimit paqësor të pasurisë së tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publik dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. [...]

LIGJI Nr. 04/L-034 PËR AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT
KREU I
STATUSI LIGJOR,
QËLLIMET DHE PËRKUFIZIMET

Neni 1

Themelimi dhe statusi ligjor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit

1. Agjencia Kosovare e Privatizimit (më tej "Agjencia") është organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht autonome. Agjencia ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

[...]

Neni 2

Synimi dhe qëllimi

1. Në pajtim me kushtet e përcaktuara në këtë ligj, Agjencia është e autorizuar për administrimin, duke përfshirë autorizimin për shitjen, transferimin dhe/ose likuidikimin e ndërmarrjeve dhe aseteve të përkufizuara në këtë ligj.

2. Për realizimin e këtij synimi, Agjencia:

2.1. deri në shitjen ose zgjidhjen në mënyrë tjetër sipas këtij ligji, mban dhe administron secilën ndërmarrje dhe aset në mirëbesim dhe në të mirë të pronarëve dhe kreditorëve të tyre, në përputhje me këtë ligj dhe dispozitat tjera të zbatueshme të së drejtës së Kosovës;

2.2. shet, transferon ose likuidon ndërmarrjet dhe asetet në përputhje me nenet 6, 8 dhe 9 të këtij ligji, pa vonesa të panevojshme;

[...]

Rregullat e Përgjithshme të Tenderit-Shitja përmes Likuidimit

Hyrja

Me këto rregulla të tenderit përcaktohen procedurat për shitjen e "artikujve të tenderuar" përmes likuidimit, sic janë definuar me këto rregulla të tenderit, duke përfshirë kushtet dhe kriteret për paraqitjen e ofertave nga ana e ofertuesve, kushtet dhe kriteret për klasifikimin dhe përzgjedhjen e ofertave nga ana e Agjencisë si dhe kushtet e kriteret për lidhjen e kontrateve të shitjes me ofertyesit fitues të përkohshëm.

Neni 17

Shtyrja dhe anulimi i tenderit

17.1 Bordi sipas zgjedhjes së tij mund të shtyjë apo edhe të anulojë tenderin në çfarëdo kohe ose për çfarëdo arsye.

17.2 Duke mos kufizuar përgjithësinë e nenit 17.1, dhe pa paragjykuar për çfarëdo shkaku tjetër të shtyrjes ose anulimit të tenderit të përcaktuar me Rregullat e Tenderit, Bordi mund të marrë vendim për shtyrjen apo anulimin e tenderit, në rrethanat e paraqitura si në vijim:

[...]

(c) nëse sipas mendimit të Bordit, çmimi i ofertës më të lartë nuk ka lidhje racionale me vlerën e perceptuar të artikujve të tenderuar. Bordi në këtë rast si shtesë mund

të zgjedh shtyrjen e përcaktimit të ofertuesit fitues të përkohshëm deri në një datë të mëvonshme.
[...]

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

Neni 4

4.1 Gjykata vendos për kërkesëpadinë pas shqyrtimit të çështjes juridike në seancë të drejtpërdrejtë dhe publike.
[...]

Neni 5

5.1 Gjykata do t'i jep mundësi secilës palë që të deklarohet rreth kërkesave dhe thënieve të palës kundërshtare.
[...]

Neni 7

7.1 Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.
[...]

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejtë ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.
[...]

LIGJI NR. 06/L-086 PËR DHOMËN E POSAÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJET NË LIDHJE ME AGJENCINË KOSOVARE TË PRIVATIZIMIT

Neni 69

Procedurat e ankesës me gojë

1. Me nismë të tij apo në bazë të kërkesës me shkrim nga një palë, Kolegji i Apelit vendos nëse do të mbajë një apo më shumë seanca dëgjimore lidhur me ankesën gjegjëse. Kolegji i Apelit merr parasysh qfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashttrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim.
2. Gjatë seancës dëgjimore me gojë, Kolegji i Apelit kryesohet nga gjyqtari kryesues. Kryesuesi është përgjegjës për mbarevajtjen e seancës. Në fillim të çdo seance dëgjimore, Kryesuesi përcakton praninë e palëve dhe avokatëve të tyre.
3. Pala që përfaqësohet në seancë përmes avokatit, mund t'i drejtohet Kolegjit të Apelit vetëm përmes atij, përveç nëse ndonjë anëtar i Kolegjit të Apelit ia parashton asaj pale një pyetje drejtpërdrejt.
4. Pas hapjes së seancës me gojë, gjyqtari kryesues paraqet një hyrje të shkurtër të ankesës, çështjeve ligjore të kontestuara dhe qfarëdo gjetje faktike të konstatuar nga vendimmarrësi i Aktvendimit apo Aktgjykimit gjegjës, për të cilin pala pretendon se është "qartazi i pasaktë".
5. Në dëgjimin me gojë, palëve mund t'u jepet mundësia për të bërë një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre ligjore. Palët kufizojnë prezantimet e tyre në faktet dhe provat që pasqyrohen në shënimet që janë të rëndësishme për ankesën dhe

çështjet ligjore që janë të rëndësishme për ankesën. Kolegji i Apelit mund të caktojë një afat të arsyeshëm kohor për secilën palë për prezantimet e tilla.

6. Përveç nëse lejohet në mënyrë të veçantë në bazë të nenit 70 të këtij ligji, gjyqtari(ët) nuk do të nis procedurat për vlerësimin e provave.

7. Procesmbajtësi kujdeset që procesverbali fjalë-për-fjalë i të gjitha seancave mbahet dhe regjistrohët nga raportuesi i gjykatës. Procesverbali i tillë nënshkruhet nga Kryesuesi.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

45. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të parashikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

46. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në lidhje me paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

Neni 113

[Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara]

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

[...]

47. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen më tutje në Ligj, përkatësisht me nenet 47, 48 dhe 49 të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47

(Kërkesa individuale)

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48

(Saktësimi i kërkesës)

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49

(Afatet)

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor. Në të gjitha rastet e tjera, afati fillon të ecë në ditën kur vendimi ose akti është shpallur publikisht...”

48. Përkitazi me përmbushjen e kriterëve të lartcekura, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës është palë e autorizuar, në kuptim të paragrafit 7 të nenit 113 të Kushtetutës; ai e konteston kushtetutshmërinë e një akti të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin [AC-I-15-0157-A0001] e 3 shkurtit 2023, të Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion, sipas nenit 113.7 të Kushtetutës dhe nenit 47.2 të Ligjit; i ka specifikuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë, të cilat pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit; dhe kërkesën e ka parashtuar brenda afatit ligjor prej 4 (katër) muajve, siç parasheh neni 49 i Ligjit.
49. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtuesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me paragrafin 2, të rregullit 34 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcakton:

Rregulli 34
(Kriteret e pranueshmërisë)

[....]

(2) *“Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi/ja nuk dëshmon dhe nuk e mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij/saj”.*

[....]

50. Sipas praktikës së GJEDNJ-së dhe Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në tërësinë e saj apo vetëm për ndonjë pretendim specifik. Pretendimet qartazi të pabazuara kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime të shkallës së katërt; (ii) pretendime me një mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes; (iii) pretendime të pambështetura apo të paarsyetuara; dhe (iv) pretendime konfuze dhe të paqarta (shih, rastet e Gjykatës, [KI107/21](#), parashtues *Ramiz Hoti*, Aktvendim për Papranueshmëri i 21 tetorit 2021; [KI21/21](#), parashtues *Asllan Meka*, Aktvendim për Papranueshmëri i 28 prillit 2021).
51. Gjykata rikujton se në rastin konkret, parashtuesi i kërkesës morri pjese në një tender të shpallur nga AKP-ja, në lidhje me shitjen e një prone. Përkundër që parashtuesi i kërkesës u njoftua që ishte ofertuesi me ofertën më të lartë, Bordi i AKP-së vendosi që të anulojë tenderin e shpallur, sepse e vlerësoi ofertën e parashtuesit të kërkesës “si të pamjaftueshme ekonomikisht”. Parashtuesi i kërkesës dorëzoi padi në DHPGJS-së dhe kërkoi anulimin e vendimit të Bordit të AKP-së me pretendimin se ishte në kundërshtim me rregullat e përgjithshme të tenderit. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-së e refuzoi padinë e parashtuesit të kërkesës, me arsyetimin se, bazuar në rregullat e tenderit oferta mund të refuzohej nëse vlerësohej si e pamjaftueshme ekonomikisht. Kolegji i Apelit, duke vendosur mbi bazën e ankesës së parashtuesit të kërkesës, vërtetoi vendimin e DHPGJ-së dhe arsyetoi se Bordi i AKP-së kishte autoritetin për të vendosur në lidhje me shitjen e pronës; dhe se gjykatat nuk mund ta obligojnë AKP-në të nënshkruajë kontratë me palë të treta.
52. Parashtuesi i kërkesës i konteston konstatimet e Kolegjit të Apelit i DHPGJS-së para Gjykatës, duke pretenduar shkeljen e të drejtave kushtetuese, përkatësisht të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së duke pretenduar që: (i) procedura gjyqësore në rastin e tij ishte tejzgjatur pa arsye; (ii) ishte cenuar “barazia e armëve” sepse nuk ishte njoftuar për pretendimet e palës kundërshtare dhe se gjykatat e rregullta nuk mbajtën seancë dëgjimore; (iii) gjykatat e rregullta nuk arsyetuan vendimet e tyre, dhe që ishte shkelur e drejta e tij në pronë e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së.

53. Në vijim, Gjykata fillimisht do të shqyrtojë pretendimet e parashtruesit të kërkesës përkitazi me shkeljet e pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, për të vazhduar me pretendimin e tij për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

A. Pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

54. Gjykata rithekson se parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese, përkatësisht të drejtat e tij të garantuara me nenin 31 të Kushtetutës në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, sepse sipas parashtruesit: (i) procedura gjyqësore në rastin e tij ishte tejzgjatur pa arsye, (ii) ishte cenuar “barazia e armëve” sepse nuk ishte njoftuar për pretendimet e palës kundërshtare dhe se gjykatat e rregullta nuk mbajtën seancë dëgjimore, dhe (iii) gjykatat e rregullta nuk arsyetuan vendimet e tyre.

(1) Përkitazi me pretendimin për tejzgjatjen e procedurës gjyqësore

55. Parashtruesi i kërkesës pretendon që vendimet e gjykatave të rregullta cenuan të drejtën e tij për zgjidhjen e çështjes brenda një afati të arsyeshëm kohor. Parashtruesi i kërkesës thekson se: rasti nuk ishte i komplikuar për tu vendosur, por vetëm duhej interpretuar ligji; dhe se nuk pati numër të madh të palëve apo dëshmitarëve. Sipas parashtruesit të kërkesës, veprimet e tij nuk ndikuan në tejzgjatjen e procedurës gjyqësore por neglizhenca e gjykatave të rregullta.
56. Në kuptim të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, si pjesë përbërëse e të drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në vazhdimësi ka theksuar se është detyrim i shtetit që të organizojë sistemin e drejtësisë në atë mënyrë që gjykatat të mund të garantojnë të drejtat e secilës palë për një vendim përfundimtar gjyqësor, në lidhje me të drejtat dhe obligimet civile të tyre brenda një afati të arsyeshëm (shih, rastin e Gjykatës KI64/23, parashtruese Mejrem Qehaja Rexha, Aktgjykim i 31 gushtit 2023, paragrafi 62).
57. Rrjedhimisht, në pajtim me parimet dhe kriteret e vendosura përmes kësaj praktike gjyqësore, gjatë shqyrtimit të pretendimit të parashtruesit të kërkesës, Gjykata do të marrë parasysh: (i) vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes të procedurës në tërësi; (ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave; dhe (iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës së zhvilluar para gjykatave kompetente.

(i) Përcaktimi i kohëzgjatjes së procedurës

58. Gjykata rikujton se, përlllogaritja e kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore fillon nga momenti kur gjykata kompetente vihet në lëvizje me kërkesë të palës për vendosjen e një të drejtë apo interesi legjitim të pretenduar (shih, rastet e Gjykatës KI127/15, parashtrues Mile Vasović, Akvendim për papranueshmëri i 5 qershorit 2017; rasti KI19/17, parashtrues Fatos Dervishaj, Akvendim për papranueshmëri i 20 shkurtit 2018 dhe KI64/23, parashtruese Mejrem Qehaja Rexha, cituar më lart, paragrafi 59). Në vijim të kësaj, Gjykata po ashtu ka specifikuar se (i) në përlllogaritjen e kohëzgjatjes së procedurës, merret për bazë e gjithë procedura në tërësi, përfshirë këtu edhe procedurat e apelimit; dhe (ii) procesi gjyqësor konsiderohet i përfunduar në momentin e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nga instanca e fundit gjyqësore (shih, rastet e Gjykatës KI177/19, parashtrues NNT “Sokoli”, Aktgjykim i 29 marsit 2021, paragrafi 98 dhe KI183/21, parashtrues Ejup Koci, Akvendim për papranueshmëri i 30 marsit 2022,

paragrafi 74; dhe po ashtu shih, rastin e GJEDNJ-së, Poiss kundër Austrisë, nr.9816/82, Aktgjykim i 23 prillit 1987, paragrafi 50).

59. Në rastin konkret, Gjykata thekson se periudha që duhet të merret parasysh për llogaritjen e zgjatjes së procedurës fillon nga data 6 maj 2014 – kur parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesëpadi në shkallë të parë (DHPGJS), deri më 3 shkurt 2023 – kur Kolegji i Apelit DHPGJS-së nxori aktgjykimin e formës së prerë. Periudha e tërësishme është 8 (tetë) vjet e 8 (tetë) muaj e 28 (njëzet e tetë) ditë.

(ii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

60. Gjykata mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurës e vlerëson mbi bazën e katër (4) kritereve, përkatësisht: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (ii) sjelljen e palës; (iii) sjelljen e autoriteteve; dhe (iv) rëndësisë së asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih, rastet e Gjykatës KI177/19, parashtrues NNT “Sokoli”, cituar më lart, paragrafët 96-106; KI183/21, parashtrues Ejup Koci, cituar më lart, paragrafi 85; KI19/21, parashtrues Sadik Pllana, cituar më lart, paragrafi 85; dhe shih rastet e GJEDNJ-së, Comingersoll kundër Portugalisë, nr. 35382/97, Aktgjykim i 6 prillit 2000, paragrafi 19; dhe Frydlander kundër Francës, nr. 30979/96, Aktgjykim i 27 qershorit 2000, paragrafi 43).
61. Gjykata vëren se, kontesti civil u zhvillua ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe AKP-së, e cila e kishte shpallur një tender publik për shitjen e pronës së paluajtshme. Parashtruesi i kërkesës ofroi çmimin më të lartë dhe u shpall si ofertuesi më i mirë, por Bordi i AKP-së anuloi tenderin duke argumentuar se oferta, ndonëse më e larta, nuk përputhej me vlerën reale të pronës. Parashtruesi i kërkesës pretendonte se vendimi i Bordit të AKP-së ishte arbitrar dhe i pabazuar në analizë të saktë të tregut. Megjithatë, DHPGJS-ja dhe Kolegji i Apelit e refuzuan kërkesëpadinë respektivisht ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe mbështetën vendimin e Bordit të AKP-së, duke theksuar se AKP-ja kishte autoritetin për të vendosur mbi shitjen e pronave të saj dhe për të lidhur marrëveshje kontraktuale.

a) Ndërlikueshmëria e rastit

62. Gjykata, duke afirmuar parimet e zhvilluara përmes praktikës së GJEDNJ-së, ka specifikuar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje të faktit dhe të ligjit por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, KI64/23, parashtruese Mejrem Qehaja Rexha, cituar më lart, paragrafi 66; KI183/21, parashtrues Ejup Koci, cituar më lart, paragrafi 83; dhe , KI18/18, parashtrues Isuf Musliu, cituar më lart, paragrafi 45, shih dhe rastet e GJEDNJ-së, *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, [nr.12539/86](#), Aktgjykim i 27 tetorit 1994, paragrafi 55).
63. Në rastin konkret, Gjykata vëren se çështja lidhej me interpretimin e rregulltave të tenderit përkatës, në lidhje me shitjen e njësisë numër 71, “Gërmia Shitorja nr. 197 Prishtinë/Shitja e Aseteve 23”. Palë në këtë procedurë gjyqësore ishin parashtruesi i kërkesës si paditës dhe AKP-ja si e paditur. Parashtruesi i kërkesës pretendonte që anulimi i tenderit nga AKP-ja ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore rregullat e tenderit dhe kërkoi vërtetimin si fitues i këtij tenderi. AKP-ja në anën tjetër, pretendonte se çmimi i ofruar nga parashtruesi i kërkesës nuk përputhej me vlerën reale të pronës, prandaj vendosi ta anulonte tenderin për shitjen e kësaj prone. DHPGJS-ja dhe Kolegji i Apelit vlerësuan rregullat e tenderit përkatës dhe konstatuan që AKP-ja si pronare e pronës së tenderuar, kishte autoritetin e plotë për të vendosur në lidhje me shitjen apo jo të asaj prone dhe anulimi i tenderit ishte mbështetur në arsye legjitime. Në lidhje me këtë, Gjykata thekson se rasti nuk rezulton të jetë i komplikuar për tu vendosur. Kishte

vetëm dy palë në procedurë dhe asnjëra nga to nuk kishte propozuar dëshmitarë apo ndonjë ekspertizë. Gjykatat e rregullta u morrën vetëm me interpretime ligjore të Ligjit nr. 04/L-03 dhe të rregullave të tenderit përkatës.

b) Sjellja e parashtruesit të kërkesës

64. Gjykata konsideron se sjellja e parashtruesve përbën një fakt objektiv që nuk mund t'u atribuohet gjykatave dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin, nëse procedurat vazhduan më gjatë se sa afati i arsyeshëm kohor, i garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës dhe paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës, KIO7/15, parashtrues Shefki Zogiani, cituar më lart, paragrafi 55; KIO3/22, me parashtrues EPS "Trgovina", cituar më lart, paragrafi 59; KI183/21 me parashtrues Ejup Koci, cituar më lart, paragrafi 86; dhe rastet e GJEDNJ-së, McFarlane kundër Irlandës, nr. 31333/06, Aktgjykim i 10 shtatorit 2010, paragrafin 148; Eckle kundër Gjermanisë, nr. 8130/78, Aktgjykim i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).
65. Në lidhje me sjelljen e palës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në DHPGJ-se kundër vendimit të AKP-së për anulimin e tenderit. Po ashtu, ai paraqiti edhe propozimin për caktimin e masës së sigurimit, në mënyrë që t'i ndalohej AKP-së shitja e pronës deri në vendimin meritore. Parashtruesi i kërkesës fillimisht parashtrroi dy ankesa: një të kundër vendimit të DHPGJS-së që ia refuzoi propozimin për caktimin e masës së sigurimit; dhe tjetrën kundër aktgjykimit të DHPGJS-së që ia refuzoi kërkesëpadinë si të pabazuar. Parashtruesi i kërkesës paraqiti edhe dy ankesa në Kolegjin e Apelit: të parën kundër vendimin të DHPGJS-së për refuzimin e masës së sigurimit; dhe të dytën kundër aktgjykimit të DHPGJS-së për refuzimin e kërkesëpadisë. Gjykata vlerëson se, veprimet e parashtruesit të kërkesës nuk ndikuan në zvarritjen e procedurës. Ai thjesht i përdori të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj, për të realizuar interesat e tij juridike.

a) Sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore

66. Gjykata fillimisht vë në dukje qëndrimin parimor të GJEDNJ-së se paragrafi 1 i nenit 6 të KEDNJ-së kërkon nga shtetet kontraktuese që të organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të atillë që autoritetet kompetente të përmbushin kërkesat e nenit në fjalë, duke përfshirë edhe detyrimin për të shqyrtuar çështjet brenda një afati të arsyeshëm kohor (shih, rastet e Gjykatës, KIO3/22, me parashtrues EPS "Trgovina", cituar më lart, paragrafi 63; KI183/21 me parashtrues Ejup Koci, cituar më lart, paragrafi 97; KI202/22 me parashtrues NP "Elektroprivreda Srbije" Aktvendim për papranueshmëri i 14 marsit 2024; dhe shih, rastet e GJEDNJ-së, Luli dhe të tjerët kundër Shqipërisë, nr. 64480/09 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12, Aktgjykim i 1 prillit 2014, paragrafi 91; Abdoella kundër Holandës, nr. 12728/87, Aktgjykim i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24, Mishgjoni kundër Shqipërisë, nr. 18381/05, Aktgjykim, i 7 dhjetorit 2010).
67. Sa i përket veprimeve nga gjykatat e rregullta, Gjykata vëren se Kolegji i Specializuar i DHPGJS refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar dhe aktgjykimin e nxori pas 1 viti e 2 muajsh. Kolegji i Apelit, duke vendosur mbi ankesën e parashtruesit të kërkesës, nxori aktgjykimin për refuzimin e ankesës pas 7 vitesh e 5 muajsh. Pra, periudha e tërësishme e vendimmarrjes nga gjykatat e rregullta për refuzimin e kërkesëpadisë së parashtruesit të kërkesës është tetë (8) vite e tetë (8) muaj. Brenda kësaj periudhe, gjykatat e rregullta vendosën edhe për propozimin për caktimin e masës së sigurimit. Kolegji i Specializuar i DHPGJS-ja për vetëm dy (2) muaj e refuzoi përmes aktvendimit propozimin për masën e sigurimit. Ndërkaq, Kolegji i Apelit i DHPGJS-se nxori aktvendim për refuzimin e ankesës së parashtruesit të kërkesës në lidhje me masën e sigurimit, për katër (4) vite e dy (2) muaj.

68. Megjithatë, Gjykata rikujton se për llogaritjen e afatit merret parasysh gjithë procedura gjyqësore në tërësinë e saj. Gjykata kishte konstatuar shkelje kur Gjykata Themelore për më shumë se katërmëdhjetë (14) vite nuk kishte nxjerrë aktgjykim meritore për kërkesëpadinë në kontest civil (shih, rastin e Gjykatës, KI64/23, parashtrues Mejrem Qehaja Rexha, Aktgjykim i 31 gushtit 2023, paragrafët 75-98). Gjykata kishte konstatuar tejzgjatje të procedurës gjyqësore në rastin kur Gjykata Themelore dhe Gjykata e Apelit nuk kishin arritur të marrin aktgjykim të formës së prerë në lidhje me kërkesëpadinë e palës për gjashtëmbëdhjetë (16) vite (shih, rastin e Gjykatës, KI06/21, parashtrues Dragan Mihajloviq, Aktgjykim i 22 dhjetorit 2022, paragrafi 76-77).
69. Gjykata kishte konstatuar se pretendimet e parashtruesve të kërkesës ishin qartazi të pabazuara për shkelje tejzgjatjes së procedurës, kur procedura para gjykatave të rregullta kishte zgjatur tetë (8) vite e gjashtë (6) muaj, për shkak të kompleksitetit të rastit, palëve të përfshira në rast dhe faktit që gjykatat e rregullta nuk ishin treguar pasive (shih, rastin e Gjykatës KI127/15, parashtrues Mile Vasovic, Aktvendim për papranueshmëri i 5 qershor 2017, paragrafët 49-55). Gjykata nuk kishte vlerësuar se kishte tejzgjatje të procedurës gjyqësore pranë DHPGJS-së, kur ajo kishte zgjatur gjashtë (6) vite e nëntë (9) muaj gjithsejtë, për shkak të kompleksitetit të rastit dhe faktit që rasti nuk bënte pjesë në kategorinë e rasteve që duhet trajtuar me urgjencë (KI23/16, parashtrues Qazim Bytyqi dhe tjerët, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafët 73-75).

a) Rëndësia e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest

70. Lidhur me kriterin e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest, Gjykata i referohet praktikës gjyqësore të vet Gjykatës e cila bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sqaron se një kategori e rasteve kërkon zgjidhje të veçantë ekspeditive (shih, rastet e Gjykatës, KI202/22, me parashtrues NP “Elektroprivreda Srbije”, cituar më lart, paragrafët. 78-79; dhe KI23/16, parashtrues Qazim Bytyqi dhe tjerët, cituar më lart, paragrafët 59-75).
71. Në rastin konkret, Gjykata thekson se kontesti lidhej me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për ta blerë pronën e paluajtshme nëpërmjet tenderit publik të shpallur nga AKP-ja. Rrjedhimisht, parashtruesi i kërkesës nuk ishte pronarë i pronës së paluajtshme por vetëm shpresonte të ishte blerës i saj përmes tenderit publik të shpallur nga AKP-ja. Me fjalë të tjera, parashtruesi i kërkesës nuk kishte diçka serioze që i rrezikohet nga ky kontest dhe çështja e tij nuk bënte pjesë në rastet për të cilat kërkohet vëmendje e shtuar dhe vendimmarrje më e shpejtë.
72. Rrjedhimisht, duke pasur parasysh kriteret e lartcekura të vendosura përmes praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe të afirmuara edhe përmes praktikës gjyqësore të vet Gjykatës përkitazi me të drejtën për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 2 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, Gjykata konstaton se pretendimi i parashtruesit të kërkesës lidhur me tejzgjatjen e procedurës në tërësinë e saj dhe moszgjidhjen brenda një afati të arsyeshëm, është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese për shkak se është i “pambështetur apo i paarsyetuar” dhe duhet të shpallet i papranueshëm në pajtim me paragrafin (2) të rregullit 34 të Rregullores së punës.
- (2) Përkitazi me pretendimet për shkeljen e parimit të “barazisë së armëve” dhe për mos mbajten e seancës gjyqësore*
73. Parashtruesi i kërkesës pretendon që nuk kishte pasur mundësinë të paraqiste pretendimet e tij dhe as nuk kishte ishte vënë në dijeni për argumentet e palës kundërshtarë, gjë që sipas tij bie ndesh me konceptin e “barazisë së armëve”.

Parashtruesi i kërkesës thekson gjithashtu se gjykatat e rregullta vendosën për çështjen pa mbajtur seanca dëgjimore.

74. Rrjedhimisht, në vlerësimin e pretendimeve të lartcekura, Gjykata do të shtjellojë (i) parimet e përgjithshme përkitazi me (a) parimin e kontradiktoritetit dhe (b) të drejtën për një seancë dëgjimore të garantuar me paragrafin 1 të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, për aq sa janë relevante në rrethanat e rastit konkret, për të vazhduar me (ii) aplikimin e këtyre parimeve të përgjithshme në rrethanat e rastit konkret. Këto kategori pretendimesh, Gjykata do t'i shqyrtojë duke u bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës dhe të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, bazuar në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
75. Gjykata bazuar në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore dhe bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, fillimisht e konsideron të rëndësishme të ritheksojë qëndrimin e përgjithshëm se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura të Kushtetutës, dhe të KEDNJ-së, nuk është drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Në rrafshin praktik, koncepti i “drejtësisë procedurale” nënkupton: (i) mundësinë e procedurave kontradiktore/parimi i kontradiktoritetit procedural; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të procedurës të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur (shih, rastet e Gjykatës KI177/22, parashtrues Pashk Bibaj, Aktgjykim, i 4 shtatorit 2024, paragrafi 70; [KI42/16](#), me parashtrues *Valdet Sutaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 17 nëntorit 2016, paragrafi 41; dhe rastet e Gjykatës Kushtetuese: [KI128/19](#), me parashtrues *Artan Mala*, Aktvendim për papranueshmëri, i 25 shkurtit 2021, paragrafi 58; [KI22/19](#), parashtrues *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 7 qershorit 2019, paragrafi 42; dhe [KI148/21](#), me parashtrues *Fatos Dervishaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 8 tetorit 2019, paragrafi 58; dhe po ashtu shih, në mënyrë të ngjashme rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, nr. 10590/83, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68).
76. Në vijim të kësaj, Gjykata duke vendosur theksin në pretendimin thelbësor të parashtruesit të kërkesës e që ndërlihet me të drejtën për mbajtjen e seancës dëgjimore, vë në dukje se praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka vendosur parimet themelore përkitazi me të drejtën për një seancë dëgjimore. Bazuar në këtë praktikë gjyqësore, Gjykata gjithashtu ka përcaktuar parimet dhe përjashtimet përkatëse, bazuar në të cilat vlerësohet domosdoshmëria e mbajtjes së një seance dëgjimore, varësisht nga rrethanat e rasteve përkatëse. Në vijim të kësaj, përmes një numri aktgjykimesh, Gjykata ka vënë theks në këto parime, duke konstatuar shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së për shkak të mungesës së një seance dëgjimore para DHPGJS-së, përkatësisht edhe para Kolegjit të Specializuar edhe Kolegjit të Apelit (shih, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, me parashtrues Et-hem Bokshi dhe të Tjerët, Aktgjykim, i 10 dhjetorit 2020; KI160/19, KI161/19, KI162/19, KI164/19, KI165/19, KI166/19, KI167/19, KI168/19, KI169/19, KI170/19, KI171/19, KI172/19, KI173/19 dhe KI178/19, me parashtrues Muhamet Këndusi dhe të tjerët, Aktgjykim i 27 janarit 2021; KI181/19, KI182/19 dhe KI183/19, me parashtrues Fllanza Naka, Fatmire Lima dhe Leman Masar Zhubi, Aktgjykim i 27 janarit 2021; KI220/19, KI221/19, KI223/19 dhe KI234/19, me parashtrues Sadete Koca Lila dhe të tjerët, Aktgjykim, i 25 marsit 2021; dhe KI186/19; KI187/19, KI200/19 dhe

KI208/19, me parashtrues Belkize Vula Shala dhe të tjerët; Aktgjykim, i 28 prillit 2021 dhe KI01/20, me parashtrues Momir Marinković, Aktgjykim, i 29 korrikut 2021).

77. Në parim, palët ndërgjyqëse kanë të drejtë për një seancë dëgjimore publike, por një detyrim i tillë nuk është absolut. Për aq sa është relevante për rrethanat e tanishme, praktika gjyqësore e Gjykatës mbështetur në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së ka zhvilluar parimet kryesore që kanë të bëjnë me (i) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së parë; (ii) të drejtën për një seancë dëgjimore në gjykatat e shkallës së dytë dhe të tretë; (iii) parimet në bazë të të cilave duhet të përcaktohet nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme; dhe (iv) nëse mungesa e dëgjimit në shkallën e parë mund të korrigjohet përmes një seance dëgjimore në një shkallë më të lartë dhe kriteret përkatëse për të bërë këtë vlerësim. Sidoqoftë, në të gjitha rrethanat, mungesa e një seance dëgjimore duhet të jetë e arsyetuar nga gjykata përkatëse (shih, rastet e Gjykatës në rastin e ish-ndërmarrjes “Agimi”, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët, të cituar më lart, paragrafi 48 dhe KI01/20, parashtrues Momir Marinkovic, Aktgjykim i 29 korrikut 2021, paragrafi 44).
78. Gjykata duke iu referuar në vazhdimësi praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së dhe asaj të Gjykatës thekson se fakti që palët nuk kanë kërkuar mbajtjen e një seance dëgjimore nuk do të thotë që të njëjtat kanë hequr dorë nga e drejta për të mbajtur një të tillë (shih, rastet e Gjykatës, KI145/19, KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, parashtrues Et-hem Bokshi dhe të tjerët, të cituar më lart, paragrafi 54). Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, një çështje e tillë varet nga karakteristikat e ligjit vendor dhe rrethanat e secilit rast veç e veç (shih, rastin e GJEDNJ-së, Göç kundër Turqisë, cituar më lart, paragrafi 48).
79. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se paragrafi 1 i nenit 69 të Ligjit për DHPGJS-në përcakton që: *“Kolegji i Apelit merr parasysh çfarëdo kërkesë për procedurë gojore që parashtrohet nga ndonjëra palë, e cila paraqet arsyet e saja për parashtrimin e kërkesës për procedurë gojore. Kërkesa e tillë parashtrohet para përfundimit të procedurave të ankesës me shkrim”*.
80. Në vijim, paragrafi 4 i po të njëjtit nen përcakton që: *“Pas hapjes së seancës me gojë, gjyqtari kryesues paraqet një hyrje të shkurtër të ankesës, çështjeve ligjore të kontestuara dhe çfarëdo gjetje faktike të konstatuar nga vendimmarrësi i Aktvendimit apo Aktgjykimit gjegjësisht, për të cilin pala pretendon se është “qartazi i pasaktë”*. Përderisa paragrafi 5 i nenit 69 të Ligjit, në kuptim të parimit të kontradiktoritetit dhe barazisë së armëve palëve i mundëson ofrimin e *“[...] një prezantim të shkurtër verbal të argumenteve të tyre ligjore. Palët kufizojnë prezantimet e tyre në faktet dhe provat që pasqyrohen në shënimet që janë të rëndësishme për ankesën dhe çështjet ligjore që janë të rëndësishme për ankesën. Kolegji i Apelit mund të caktojë një afat të arsyeshëm kohor për secilën palë për prezantimet e tilla”*.
81. Gjykata rithekson se në parim, palët kanë të drejtë për një seancë dëgjimore, por një gjë e tillë nuk është absolute dhe varet nga rrethanat dhe karakteristikat e rastit. Për shembull, përjashtim nga ky rregull hyjnë rastet që kanë të bëjnë me çështje ligjore ose të natyrës shumë teknike. Për të përcaktuar nëse një seancë dëgjimore është e domosdoshme, atëherë duhet të vlerësohet nëse: (i) rasti ngërthen thjesht çështje juridike të një natyre të kufizuar ose nuk ngërthen ndonjë ndërlikueshmëri të veçantë; (ii) rasti ngërthen çështje teknike, të cilat trajtohen më mirë me shkrim sesa përmes argumenteve verbale; (iii) rasti nuk ngërthen çështje të besueshmërisë së palëve ose fakteve të kontestuara dhe gjykatat mund të vendosin në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në bazë të parashtrësive të palëve dhe materialeve të tjera me shkrim. Në të kundërtën, një

seancë dëgjimore është e domosdoshme nëse: (i) rasti ngërthen nevojën për shqyrtimin e çështjeve të ligjit dhe të faktit, përfshirë rastet në të cilat është i nevojshëm vlerësimi nëse autoritetet më të ulëta kanë vlerësuar faktet në mënyrë të saktë; (ii) rasti kërkon që gjykata përkatëse të fitojë një përshtypje personale për palët përkatëse, dhe t'u lejohet palëve mundësia të sqarojnë gjendjen personale (rasti i Gjykatës, KI160/20, parashtues Komuna e Gjiçanit, Aktvendim për papranueshmëri i 11 majit 2020, paragrafët 68-79).

82. Përkitazi me pretendimin për mos mbajtje të seancës dëgjimore, Gjykata në jurisprudencën e saj ka konstatuar shkelje në rastet kur Kolegji i Apelit të DHPGJS-së ka vlerësuar çështje të faktit dhe të ligjit duke e ndryshuar kështu vendimin e Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së në dëm të parashtuesve të kërkesës (shih rastin e Gjykatës KI145/19, KI146/19, KI147/19, KI149/19, KI150/19, KI151/19, KI152/19, KI153/19, KI154/19, KI155/19, KI156/19, KI157/19 dhe KI159/19, cituar më lart, paragrafi 81). Gjykata në jurisprudencën e saj po ashtu ka konstatuar se mos mbajtja e seancës dëgjimore nga Kolegji i Specializuar dhe Kolegji i Apelit të DHPGJS-së nuk bie ndesh me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 (1) të KEDNJ-së, për shkak se rasti karakterizohet nga çështje të “natyrës së lartë teknike” apo “ekskluzivisht ligjore” dhe se i njëjti mund të zgjidhet në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme bazuar në parashtresat dhe materialet tjera të dorëzuara nga palët (shih rastin e Gjykatës KI160/20, cituar më lart, paragrafët 98-105).
83. Gjykata vëren se, në rastin konkret DHPGJS-ja dhe Kolegji i Apelit nuk mbajtën seanca dëgjimore gjatë procedurës gjyqësore. Parashtuesi i kërkesës në ankesën e tij drejtuar Kolegjit të Apelit kishte theksuar mungesën e mbajtjes së seancës dëgjimore në shkallën e parë, si një nga shkeljet e procedurës kontestimore. Kolegji i Apelit në Aktgjykimin [AC-I-15-0157-A0001] e 3 shkurtit 2023 kishte theksuar se *“Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit mbi Dhomën e Posacme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, Kolegji i Apelit vendos që të heq dorë nga pjesa gojore e procedurës.”*
84. Siç u theksua më lart, praktika gjyqësore e Gjykatës ka gjetur shkelje për mos mbajtje të seancës dëgjimore kur Kolegji i Apelit e kishte prishur vendimin e shkallë së parë në dëm të parashtuesve të kërkesës. Gjykata thekson se në rastin konkret, shkalla e parë e DHPGJS-së e kishte refuzuar kërkesëpadinë e parashtuesit të kërkesës pa mbajtur seancë dëgjimore. Kolegji i Apelit e kishte vërtetuar aktgjykimin dhe e kishte refuzuar ankesën e parashtuesit të kërkesës. Gjykata vlerëson se neni 69.1 i Ligjit për DHPGJS-në, të cilit i është referuar Kolegji i Apelit, i japin mundësinë kësaj të fundit të vendosë nëse do të mbajë seanca dëgjimore apo jo. Pra, është në diskrecionin e saj që të vendosë për një çështje të tillë, varësisht të karakteristikave të rastit.
85. Në lidhje me mosmbajtjen e seancës dëgjimore në shkallë të parë, Gjykata vlerëson se çështja ishte e natyrës “ekskluzivisht ligjore” – interpretimit të rregullave të përgjithshme të tenderit. Kur natyra juridike e rastit lidhet vetëm me interpretime të ligjit, atëherë mund të arsyetohet mosmbajtja e seancës dëgjimore nga gjykatat e rregullta. Në rastin konkret, çështja nuk ishte komplekse dhe gjykatat e rregullta e kishin krijuar bindjen e tyre pasi kishin shqyrtuar dokumentet në dosje dhe pa zhvilluar seancë dëgjimore, prandaj mosmbajtja e seancës dëgjimore ishte e justifikueshme.
86. Për më tepër, Gjykata vlerëson se mosmbajtja e seancës dëgjimore nuk ka ndikuar në rregullësinë e procesit gjyqësor dhe në meritat e rastit. Parashtuesi i kërkesës kishte të gjitha mundësitë për t'i paraqitur pretendimet, provat dhe argumentimet e veta dhe nuk ishte vendosur në pozitë të pabarabartë në asnjë fazë të procedurës gjyqësore.
87. Në rastin konkret, Gjykata vlerëson se parashtuesi i kërkesës kishte pasur mundësinë t'i paraqiste të gjitha pretendimet dhe argumentet e tij juridike në formë të shkruar pranë

dy instancave të gjykatave të rregullta. Në padinë dhe ankesën e tij, ai kishte theksuar argumentet mbi bazën e së cilave mbështeste pretendimet e tij. Gjykata vlerëson se të dy instancat gjyqësore adresuan këto pretendime të parashtruesit të kërkesës.

88. Gjykata konstaton se pretendimet për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me “barazinë e armëve” dhe mosmbajtjen e seancës dëgjimore, i përkasin pretendimeve “*me mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe shpallen qartazi të pabazuara.

(3) përkitazi me pretendimin për mosarsyetimin e vendimit gjyqësor

89. Parashtruesi i kërkesës pretendon që aktgjykimi i Kolegjit të Apelit nuk përmban arsyetime të mjaftueshme në lidhje me konstatimin e fakteve.
90. Gjykata rithekson se është obligim i gjykatave të rregullta të arsyetojnë vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih, rastet e Gjykatës, KI143/22, parashtrues Hidroenergji sh.p.k, Aktgjykim, i 15 dhjetorit 2022, paragrafi 116; dhe KI40/20, parashtrues Sadik Gashi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 20 janarit 2021, paragrafi 49; dhe shih, rastin e GJEDNJ-së, Garcia Ruiz kundër Spanjës, nr. 30544/96, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 26). Masa në të cilën zbatohet ky detyrim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast (shih, rastin e GJEDNJ-së, Ruiz Torija kundër Spanjës, nr. 18390/91, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29 dhe 30). Një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa konsideratë të mjaftueshme (shih, rastet e Gjykatës, KI208/23, parashtrues Telekom i Kosovës Sh.A, Aktvendim për Papranueshmëri, i 31 janarit 2024, paragrafi 55; KI143/22, Hidroenergji sh.p.k, i cituar më lart, paragrafi 121; dhe KI40/20, parashtrues Sadik Gashi, i cituar më lart, paragrafi 49).
91. Gjykata vëren se, Bordi i AKP-së anuloi tenderin për shitjen e pronës përkundër faktit që oferta e parashtruesit të kërkesës ishte më e larta, në vlerë prej 280.001 euro. Në arsyetimin për anulimin e tenderit, Bordi i AKP-së vlerësoi që oferta e parashtruesit të kërkesës nuk ishte në përputhje me vlerën reale të pronës. Paraprakisht, Bordi i AKP-së kishte refuzuar shitjen e pronës së njëjtë për një vlerë prej 452.000 euro. Neni 17 i Rregullave të përgjithshme të tenderit, të shpallur nga AKP-ja, përcaktonte se Bordi mund të anulonte tenderin në çfarëdo kohë dhe për çfarëdo arsye. I njëjti nen, gjithashtu parashihte mundësinë e anulimit të tenderit, nëse Bordi vlerësonte se çmimi i ofertës më të lartë nuk ka lidhje racionale me vlerën e perceptuar të artikujve të tenderuar.
92. Gjykata vëren se, DHPGJS-ja e vlerësoi si të drejtë vendimin e Bordit dhe arsyetoi që “*Neni 17.2 i Rregullave të tenderit parasheh se ofera mund të anulohet nëse është e pamjaftueshme ekonomikisht [...]*.” DHPGJS-ja vlerësoi se “*në procedurën e tenderit paraprak ka qenë oferta prej 452.000 euro për të njëjtat arsye. Kjo paraqet se tregu e ka potencialin për të ngritur shumë më tepër çmimin sesa oferta e paraqitur nga ana e paditësit [...] prandaj është e besueshme se i padituri nuk e ka anuluar tenderin në mënyrë arbitrare për paditësin*”.
93. Gjykata gjithashtu vëren se Kolegji i Apelit, mbi bazën e ankesës, pranoi vendimin e shkallës së parë dhe arsyetoi njëjtë. Kolegji i Apelit, ndër të tjera theksoi se “*gjykata nuk është e autorizuar me ndonjë dispozitë ligjore ta obligoj AKP-në që të nënshkruaj kontratën sepse AKP-ja është organ i pavarur publik (neni 1.1 i Ligjit për AKP-në) dhe prandaj është e pavarur të vendosë me kë të futet në marrëdhënie kontraktuale*”.

Kolegji i Apelit poashtu theksoi se “Bordi i AKP-së kishte vendosur që të mos aprovoj shitjen për shkak të çmimit të lirë të ofruar, që sipas vlerësimit të shkallës së parë të DHPGJS dhe Kolegjit të Apelit është në pajtim me ushtrimin e arsyeshëm të autoritetit të saj”.

94. Gjykata vlerëson se, Kolegji i Apelit pranoi vendimin e shkallës së parë dhe përsëriti arsyetimin e njëjtë. Kjo teknikë e arsyetimit, kur shkalla e dytë thjesht pranon vendimin e shkallës më të ulët, bazuar në rrethanat e rastit mund të konsiderohet e arsyeshme.
95. Gjykata vlerëson se në rastin konkret, e gjithë çështja kishte të bënte me interpretimin e dispozitave relevante dhe arsyetimi i gjykatave të rregullta mund të konsiderohet i mjaftueshëm në raport me thelbin e çështjes.
96. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, përkitazi me mosarsyetimin e vendimit gjyqësor, i përkasin pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyeturara” dhe shpallen qartazi të pabazuara.

Pretendimet për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit numër 1 të KEDNJ-së

97. Parashtruesi i kërkesës pretendon që gjykatat e rregullta ia shkelën të drejtën e tij në pronë, për shkak se AKP-ja anuloi tenderin për shitjen e pronës për të cilën parashtruesi i kërkesës ishte shpallur ofertuesi më i lartë. Sipas tij, kjo i shkaktoi dëme të konsiderueshme materiale sepse me rastin e shpalljes si ofertuesi më i lartë, kishte pritshmëri legjitime se do të ishte blerësi dhe pronari i pronës.
98. Në lidhje me këtë të fundit, Gjykata rikujton se neni 46 i Kushtetutës nuk garanton të drejtën për fitimin e pronës. Një qëndrim i tillë mbështetet edhe në praktikën e GJEDNJ-së (shih Van der Mussele kundër Belgjikës, Aktgjykimi i 23 nëntorit 1983, paragrafi 48; dhe Slivenko dhe të tjerët kundër Letonisë, Aktgjykimi i 9 tetorit 2003, paragrafi 121).
99. Parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, vetëm për atë sa vendimet e kontestuara kanë të bëjnë me pronën e tyre. Brenda kuptimit të kësaj dispozite, pronë mund të jetë pasuria ekzistuese, duke përfshirë edhe pretendimet në bazë të të cilave parashtruesit e kërkesës mund të pretendojnë “pritshmëri legjitime” që do të fitojnë gëzimin efektiv të ndonjë të drejte pronësore (shih, rastet e Gjykatës KI203/21 dhe KI205/21, parashtrues Sahit Kabashi dhe Nexhmije Kabashi, Aktvendim për Papranueshmëri, i 9 marsit 2022, paragrafët 104-105; KI26/18, me parashtrues Jugokoka, Aktvendimi për papranueshmëri, i 6 nëntorit 2018, paragrafi 49; KI156/18, me parashtrues Verica (Aleksić) Vasić dhe Vojislav Čađenović, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 korrikut 2019, paragrafi 52; dhe KI41/19, me parashtrues Ramadan Kočinaj, Aktvendim për papranueshmëri, i 15 janarit 2020, paragrafi 60).
100. Gjykata po ashtu vë në pah se parashtruesi i kërkesës pretendimin e tij për shkelje të nenit 46 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së po ashtu e ndërlidhë me pretendimet e tij për shkelje të së drejtës së tij për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës, në ndërlidhje me nenin 6 të KEDNJ-së. Në këtë kuptim, Gjykata rikujton se përkitazi me pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së ka konstatuar se pretendimet e tij të lartcekura i shpalli si të papranueshme si qartazi të pabazuara në baza kushtetuese ashtu siç përcaktohet me rregullin 34 (2) të Rregullores së punës.

101. Gjykata konstaton se pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkeljen e nenit 46 të Kushtetutës në lidhje me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNj-së përkitazi me “pritshmëritë legjitime”, i përkasin pretendimeve “të pambështetura apo të paarsyetuara” dhe shpallen qartazi të pabazuara.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 47 të Ligjit dhe me rregullin 48 (1) (b) të Rregullores së punës, më 1 tetor 2024, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve dhe, në pajtim me paragrafin 4 të nenit 20 të Ligjit, ta publikojë në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës;
- III. Ky aktvendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në pajtim me paragrafin 5 të nenit 20 të Ligjit.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Gresa Caka-Nimani